REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org Unit: 02
Nr.Prot: / Broj Prot: / Prot.No: 05-5074
Nr.i faqeve / Br.stranica / No.pages: -6-
Data: / Datum: / Date: 01/07/2024
Prishtinë / a

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVSTVA/MINISTRY OF HEALTH

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Ured Stalnog Sekretara/Office of the Secretary General

DATË/A:	**28.06.2024**
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	**Znj.Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme**
CC:	**Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë** **Znj. Kadrije Berisha-Zyrtar Kryesor Financiar, Ministria e Shëndetësisë**
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	**Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm i MSh**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i ZKA për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar 2023**

E nderuar znj. Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Bazuar në Rregulloren e punës për zbatimin e Auditimit të planeve të veprimit e miratuar nga Auditori i Përgjithshëm neni 14 pika 1, brenda 30 ditëve nga pranimi i raportit të auditimit, entiteti i audituar dorëzon Auditorit të Përgjithshëm një Plan Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Bashkangjitur gjeni Plani i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i ZKA për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar 2023.

Me respekt,

	Ministria e Shëndetësisë **Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i ZKA për Ministrinë e Shëndetësisë për vitin e përfunduar 2023**				
	Raporti i Kapitujve	**Institucionet përgjegjëse - Departamenti**	**Aktivitetet**	**Afati i Implementimit**	**Raporti i zbatimit**
	6 Rekomandime				
	2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit				
	Çështja A1 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente				
	Rekomandimi A1 Ministri, duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.	DL ZKF DSISh	- DL obligohet që cdo muaj te raportoj te ZKA dhe ZKF lidhur me detyrimet kontigjente. - DL bënë përditësimin e të dhënave në databazë. - DSISh krijon pamje/raportim për zyrtarët ligjor të njësive vartëse të MSh-së	Në vazhdimësi (baza mujore)	Baza mujore
	Çështja A2 - Mbyllja e investimit në vijim pa u përfunduar projekti dhe nënvlerësimi i pasurive				
	Rekomandimi A2 Ministri duhet të siguroj që të gjitha projektet që janë në proces të ndërtimit duhet të mbesin në regjistrat e pasurive si investime në vijim te Organizata financuese deri në finalizimin e tyre		N/A *Komenti është bashkëlidhur në Raportin final*	N/A	

me qëllim që vlera e pasurive të jetë e plotë në PFV.				
Çështja B1 - Regjistrimi jo i plotë i pasurive në sistemin e-pasuria				
Rekomandimi B1 Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.	ZKA MSh AKPPM QKTGJ IKSHPK	- Përgatitja Rregullores së brendëshme për pasuri - Miratimi i Rregullit të brendshëm - Verifikim në kuartale per regjistrimin e pasurisë - Emërimi i komisioni për verifikim fizik të të gjitha pasurive	Korrik-Gusht Gusht Tetor Tetor	
2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë				
2.2.1 Investimet kapitale				
Rekomandimi A3 Ministri duhet të sigurohet përmes stafit përgjegjës që para se të realizohet pagesa, të verifikohet nëse vlera e garancionit bankar është plotësisht në përputhje me kërkesën.	DP	- Divizioni i Prokurimit në vazhdimësi përcjellë konfiskimin e ekzekutimit të tenderit	Në vazhdimësi	
2.2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale				
Çështja A4 - Mos ndjekja e procedurave të pranim dorëzimit të pasurive				

Rekomandimi A4 Ministri duhet të siguroj që të gjitha pasuritë e blera për organizatat tjera përfituese të cilat janë të përfunduara bazuar në raportet e pranimit teknik të barten tek përfituesit përmes një procedure të shkruar dhe një koordinimi të mirë me të gjithë akterët relevant.		*N/A* *Komenti është bashkëlidhur në Raportin final*	N/A	
2.2.3 Të arkëtueshmet				
Çështja B2 - Mangësi në menaxhimin e të arkëtueshmëve				
Rekomandimi B2 Mnistri duhet të sigurojë përmes burimeve njerëzore definimin e qartë të obligimeve të secilit specializant në kontratat e tyre të punës. Po ashtu, departamenti i financave duhet të lëshoj një dokument (faturë, fletëpagesë) në lidhje me obligimin që ka specializanti në përputhje me tarifat në udhëzim.	DZhSSH	- Të gjitha LL/A do të definohen në lëshimin e fletëpagesës në raste që DL konsideron që është e pranueshme.	Dhjetor	

Aneks 1

Në tabelen e bashklidhur janë të prezentuara komentet e Organizates Buxhetore Ministria e Shendetesisë ku nuk është pajtuar me të gjeturat.

Konkretisht e gjetura e parë

E gjetura: Projekti për QKMF-në e Mamushës në vlerë 791,019€, ishte pjesërisht i regjistruar si pasuri - investim në vijim në vlerë prej 291,798€. Ministria pjesën e projektit prej 499,221€ e ka mbyllur para kohe si investim në vijim përmes Thesarit, duke e larguar nga regjistri i pasurisë së MSH-së. Mbyllja e një pjese të investimit në vijim ishte bërë para kohe pasi që projekti ka përfunduar në fund të vitit 2023 (raporti i komisionit të pranimit teknik 20.11.2023) dhe për këtë shumë është nënvlerësuar pasuria

Ndikimi: Mbyllja e investimit në vijim para se projekti të finalizohet nga MSH si financues ka ndikuar në nënvlerësimin e pasurive në PFV, pasi që kjo pjesë e pasurisë nuk ka figuruar fare në regjistrat e SIMFK.

Detajet lidhur me mospajtimet janë bërë të ditura përmes komenteve me shkrim të dërguara nga Ministria.

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	**Komenti i OB-së**	**Pikëpamja e ZKA-së**
Mbyllja e investimit në vijim pa u përfunduar projekti dhe nënvlerësimi i pasurive	Ministria e Shëndetësisë duke iu referuar nenit 44 të LMFPP për mbajtje të regjistrave të vet kontabël ka bërë mbylljen e projekteve dhe ka përditësuar regjistrat kontabël të MSH-së në përputhje me aktet nënligjore siç është përcaktuar në dispozitat në fuqi. Financimi i projektit ka përfunduar në at vit sipas ligjit për ndarjet buxhetore. Me datën 21.11.2023 është bërë raporti i pranimit teknik "Ndërtimi i objektit të QKMF-së" në Mamushë, që në PFV nuk është dashur të reflektohen si pasuri e Ministrisë së Shëndetësisë, pasuria e cekur në raportin e Auditorit të Jashtëm.	Raporti i auditimit e ka trajtuar çështjen e largimit të pasurisë pa u finalizuar objekti i QKMF-së, bazuar në rregulloren e pasurive 02/2013. Komenti i MSH-së citon nenin 44 të LMFP-së që flet për regjistrat kontabël të pasurive në terma të përgjithshëm por jo edhe momentin kur një investim në vijim duhet të kaloj si pasuri në përdorim, të cilën çështje e sqaron rregullorja e pasurive. *Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.*
Mos ndjekja e procedurave të pranim dorëzimit të pasurive	E njëjta çështje në lidhje me investimet në vijim është trajtuar te A4 Mosndjekja e procedura të pranim-dorëzim të pasurive. Ne iu kemi drejtuar sipas kërkesës në muajin mars 2022 thesarit të Kosovës duke u bazuar me nenin 44 të LMFPP ku thesari ka trajtuar shkresën siç është shkruar dhe të njëjten e ka ekzekutuar. Siç edhe është informuar ekipi i juaj që pranimet e pasurive kanë ndodhur nga zyrtarët e komunave përkatëse, ku edhe i kanë dëshmitë me e-mail. Në marrëveshjen e bashkëpunimit për bashkëfinancim është cekur që regjistrimi duhet të bëhet nga komuna në SIMFK.	Nga komenti i OB-së vërehet arsyetimi në lidhje me çështjen e largimit të pasurisë ku ishte financuese (bashkëfinancuese), përderisa raporti i auditimit e ka trajtuar çështjen e largimit të tyre nga MSH pa i njoftuar organizatat përfituese dhe si pasojë e mos komunikimit pasuritë kanë mbetur jasht regjistrit të pasurive në SIMFK. *Gjetja dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.*